



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:029623

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05594632

Ac.nr.5309/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Arsim Hamzaj anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve 1.B. K., 2.B. M., 3.A. P., 4.A.R. dhe 5. A. H. që të gjithë nga Gj., përfaqësuar nga L. B. avokat nga P., kundër të paditurës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Gjakovë, përfaqësuar nga i autorizuari Musë Gjergjaj, për kontest pune, kompensim të pagave jubilarë dhe paga 13, vlera kontestit 9,370.31€, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.223/20, të datës 25.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më **19.04.2024** nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e të paditurës Komuna e Gjakovës-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, ashtu që, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.223/20, i datës 25.02.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.223/20 të datës 25.02.2021, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve 1.B. K., 2. B. M., 3. A. P., 4. A.R. dhe 5. A. H. që të gjithë nga Gjakova.

II. DETYROHET e paditura Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Gjakovë që paditësve në emër të shpërblimit jubilar dhe pagës së 13 për vitet 2018, 2019 dhe 2020 të ju paguajë paditësve shumën e të hollave siç vijon:

1. B. K. në emër të shpërblimit jubilar në lartësi prej tri pagave në lartësinë e pagës së fundit dhe atë 3x716,91€ shumën prej 2,150.73€ dhe në emër të pagave të 13 (trembëdhjeta) për vitet 2018-2019-2020 dhe atë 3x507.51€ të pagës bazë në shumën prej 1,522.53€, në shumë të përgjithshme prej 3,673.26€.

2. B. M. në emër të shpërblimit jubilar në lartësi prej dy pagave në lartësinë e pagës së fundit dhe atë 2x358.50€ shumën 717.00€ dhe në emër të pagave të 13 (trembëdhjeta) për vitet 2018-2019-2020 dhe atë 3x241.67€ të pagës bazë në shumën prej 725.01€ në shumë të përgjithshme prej 1,442.01€.

3. A. P. në emër të shpërblimit jubilar në lartësi prej dy pagave në lartësinë e pagës së fundit dhe atë 2x420.80€ shumën prej 841.60€.

4. A. R. në emër të shpërblimit jubilar në lartësi prej dy pagave në lartësinë e pagës së fundit dhe atë 2x415.92€ shumën prej 831.84€ dhe në emër të pagave të 13 (trembëdhjeta) për vitet 2018-2019-2020 dhe atë 3x290.00€ të pagës bazë në shumën prej 870.00€, në shumën e përgjithshme prej 1,701.84€.

5. A. H. në emër të shpërblimit jubilar në lartësi prej dy pagave në lartësinë e pagës së fundit dhe atë 2x 420.80€ shumën prej 841.60€ dhe në emër të pagave të 13 (trembëdhjeta) për vitet 2018-2019-2020 dhe atë 3x290.00€ të pagës bazë në shumën prej 870.00€, në shumë të përgjithshme prej 1,711.60€.

III. DETYROHET e paditura që shumat e përcaktuara si në pikën II. të dispozitivit të ju paguajë paditësve secilit veç e veç me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë 26 shkurt 2020 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 777.60€ të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura Komuna e Gjakovës për shkak të shkeljes esneçila të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësit brenda afatit ligjor kanë ushtruar përgjigje në ankesën e të paditurës, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të të paditurës me propozim që ankesa të refuzohet dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 par.1, pika d), në lidhje me nenin 2000, të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës Komuna e Gjakovës-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi paditësit B. K. etj të gjithë nga Gjakova, përmes të autorizuarit të tyre, avokat L. B. nga P., me datën 26.02.2020 kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që paditësit t'ia paguajë shumën e dy pagave të fundit në emër të shpërblimit jubilar, si dhe në emër të pagave të trembëdhjeta nga viti 2018, 2019 dhe 2020 t'ia kompensoj shumën e tri pagave sipas lartësisë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura, në përgjigje në padi e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe se sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditësit nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Më tutje ka shtuar se Ministria e Shëndetësisë me nënshkrimin e kësaj kontrate nuk ka bërë harmonizimin e saj me Ministrinë e Financave, që Komunës me qarkore buxhetore të ju lejohet ngritja e tavanit të pagave, në mënyrë që të planifikojnë edhe pagesat shtesë për stafin arsimor në kuadër të kodit ekonomik paga dhe mëditje dhe me këtë rast e paditura nuk ka mundësi financiare ti paguaj pagat jubilarë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur seancë kryesore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa themeltë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimin, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se Nga vërtetimi i QKMF-Departamenti i Administratës nr. 56 datë 05 shkurt 2021 vërtetohet se B. K. është në marrëdhënie pune në detyrat e punës mjekë specialist pediatër-konsultant në QKMF me kontratë punë në kohë të pacaktuar nga data 14 shtator 1983 me të ardhura personale mujore neto 716.91€. Sipas vërtetimit nr. 24/58 të datës 28 janar 2020 vërtetohet se paditësi B. K. është në marrëdhënie pune në punë dhe detyrat e punës spec. Pediatër në QKMF me kontratë punë në kohë të pacaktuar nga data 14 shtator 1983. Me kontratën e punës nr. 153 datë 21 mars 2012 në mes të QKMF Gjakovë në cilësi të punëdhënësit dhe të punësuarit Dr.B. K. , specialist –pediatër-konsultant i është vazhduar kontrata e punës duke filluar nga data 01 prill 2012 në kohë të pacaktuar. Paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, i është caktuar në lartësi prej 507.51€. Sipas Qarkullimit për llogari të NLB Banka të datës 28 janar 2020 paditësi B. muajin tetor 2019 dhe nëntor 2019 ka realizuar pagat nga 825.24 €, muajin dhjetor 2019 ka realizuar pagën 876.08€.

Në mes palëve nuk është kontestuese përvoja e punës së paditësve e cekuar nga ana e të autorizuarit të paditësve , ashtu siç është cekur në vërtetimet e përvojës së punës si dhe shuma e pagës bazë dhe të ardhurat mujore që kanë realizuar paditësit.

Nga vërtetimi i QKMF-Departamenti i Administratës nr. 56/1 datë 05 shkurt 2021 vërtetohet se B. M. është në marrëdhënie pune në detyrat e punës shofer në QKMF me kontratë punë në kohë të pacaktuar nga data 01 nëntor 1993 me të ardhura personale mujore neto 358.50€.Sipas vërtetimit nr. 24/6 të datës 27 janar 2020 vërtetohet se paditësi B. M. është në marrëdhënie pune në punë dhe detyrat e punës shofer në QKMF –Parku i automjeteve me kontratë punë në kohë të pacaktuar nga data 01 nëntor 1993. Me kontratën e punës nr. 374 datë 22 mars 2012 në mes të QKMF Gjakovë në cilësi të punëdhënësit dhe të punësuarit Burim Mullatahiri si shofer i lëshohet kontrata e punës duke filluar nga data 01 prill 2012 në kohë të pacaktuar. Paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, i është caktuar në lartësi prej 241.67€. Sipas Qarkullimit për llogari të BPB Bank të datës 28 janar 2020 paditësi Burim muajin tetor 2019 ka realizuar pagën 467.09 €, muajin nëntor 2019 ka realizuar pagën 470.66€ dhe muajin dhjetor 2019 ka realizuar pagën 367.81€.

Nga vërtetimi i QKMF-Departamenti i Administratës nr. 56/2 datë 05 shkurt 2021 vërtetohet se A. P. është në marrëdhënie pune në detyrat e punës infermiere në QMF-3 me kontratë punë në kohë të pacaktuar nga data 01 korrik 1992 me të ardhura personale mujore neto 420.80€. Sipas vërtetimit nr. 24/18 të datës 27 janar 2020 vërtetohet se paditësja A. P. është në marrëdhënie pune në punë dhe detyrat e punës infermiere në QMF-3 me kontratë punë në kohë të pacaktuar nga data 01 korrik 1992. Nga përshkrimi i transaksionit të llogarisë se Raiffaisen Bank datë 29 janar 2020 vërtetohet se paditësja ka realizuar pagën gjatë muajit tetor, nëntor, dhjetor 2019 shumën nga 419.16€

Nga vërtetimi i QKMF-Departamenti i Administratës nr. 56/3 datë 05 shkurt 2021 vërtetohet se Alberita Rudi është në marrëdhënie pune në detyrat e punës infermiere në QKMF me kontratë punë në kohë të pacaktuar nga data 15 maj 1997 me të ardhura personale mujore neto 415.92€. Sipas vërtetimit nr. 24/3 të datës 27 janar 2020 vërtetohet se paditësja Alberita Rudi është në marrëdhënie pune në punë dhe detyrat e punës infermiere në QKMF me kontratë punë në kohë të pacaktuar nga data 05 maj 1997. Me kontratën e punës nr. 217 datë 22 mars 2012 në mes të QKMF Gjakovë në cilësi të punëdhënësit dhe të punësuarës Alberita Rudi infermiere i vazhdohet kontrata e punës duke filluar nga data 01 prill 2012 në kohë të pacaktuar. Paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, i është caktuar në lartësi prej 290.00€ Sipas Monitorimit të transaksioneve të llogarisë të datës 20 janar 2020 të TEB Bank paditësja Alberita ka realizuar pagën muajin tetor shumën prej 443.30, muajin nëntor dhe dhjetor 2019 shumën 414.30€.

Nga vërtetimi i QKMF-Departamenti i Administratës nr. 56/4 datë 05 shkurt 2021 vërtetohet se A. H. është në marrëdhënie pune në detyrat e punës infermiere në QKMF me kontratë punë në kohë të pacaktuar nga data 10 korrik 1992 me të ardhura personale mujore neto 420.80€. Sipas vërtetimit nr. 24/2 të datës 27 janar 2020 vërtetohet se paditësja A. H. është në marrëdhënie pune në punë dhe detyrat e punës infermiere në QKMF me kontratë punë në kohë të pacaktuar nga data 01 korrik 1992. Me kontratën e punës nr. 218 datë 22 mars 2012 në mes të QKMF Gjakovë në cilësi të punëdhënësit dhe të punësuarës A.H. infermiere i vazhdohet kontrata e punës duke filluar nga data 01 prill 2012 në kohë të pacaktuar. Paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, i është caktuar në lartësi prej 290.00€ Sipas përshkrimit të transaksionit të Raiffaisen Bank të datës 28 janar 2020 paditësja A. ka realizuar pagën muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2019 nga shumë 419.16€.

Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë e cila ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2015 neni 18 paragrafi 2 përcakton se “Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”. Po ashtu neni 17 i Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë që ka hyrë në fuqi me datë 11 prill 2018 paragrafi 2 ka paraparë se ” Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësie buxhetore të punëdhënësit”.

Paragrafi 3 i këtij neni përcakton se “Punëtorët shëndetësorë, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë:

- 3.1. për 10 vite të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij;
- 3.2. për 20 vite të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy page mujore të tij;
- 3.3. për 30 vite të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të tri page mujore të tij. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë”.

Bazuar në të lartshënuarat paditësit të parë B.K. që ka mbi 30 vite përvojë pune tek e paditura në mënyrë të pandërprerë i takon kompensimi i kërkuar në emër të shpërblimit jubilar në lartësi

prej tri pagave të fundit që ka qenë në shumën prej 716.91€ shuma prej 2,150.73€ dhe në emër të pagës së 13 (trembëdhjetë) për vitet 2018,2019 dhe 2020 tri paga bazë nga 507.51€ gjithsejtë shuma prej 1,522.53€, në shumë të përgjithshme prej 3,673.26€.

Paditësit Burim Mullatahiri është në marrëdhënie pune tek e paditura më shumë se 20 vite në mënyrë të pandërprerë për këtë i takon kompensimi i kërkuar në emër të shpërblimit jubilar në lartësi të dy pagave të fundit në shumë prej 358.50€, shuma prej 715.00€ dhe në emër të pagave të 13 (trembëdhjeta) për vitet 2018, 2019, dhe 2020 dhe atë nga 241.67€ të pagës bazë prej 725.01€, në shumë të përgjithshme prej 1,442.01€.

Paditësja A. P. është në marrëdhënie pune tek e paditura më shumë se 20 vite në mënyrë të pandërprerë për këtë i takon kompensimi i kërkuar në emër të shpërblimit jubilar në lartësi të dy pagave të fundit në shumë prej 420.80€, shuma prej 841.60€.

Paditësja A. R. është në marrëdhënie pune tek e paditura më shumë se 20 vite në mënyrë të pandërprerë për këtë i takon kompensimi i kërkuar në emër të shpërblimit jubilar në lartësi të dy pagave të fundit në shumë prej 415.92€, shuma prej 831.84€ dhe në emër të pagave të 13 (trembëdhjeta) për vitet 2018, 2019, dhe 2020 dhe atë nga 290.00€ të pagës bazë prej 870.00€, në shumë të përgjithshme prej 1,701.84€.

Paditësja A. H. është në marrëdhënie pune tek e paditura më shumë se 20 vite në mënyrë të pandërprerë për këtë i takon kompensimi i kërkuar në emër të shpërblimit jubilar në lartësi të dy pagave të fundit në shumë prej 420.80€, shuma prej 841.60€, dhe në emër të pagave të 13 (trembëdhjeta) për vitet 2018, 2019, dhe 2020 dhe atë nga 290.00€ të pagës bazë prej 870.00€, në shumë të përgjithshme prej 1,711.60€.

Gjykata vlerësoi pretendimet e palës së paditur se si palë nënshkruese të Kontratës Kolektive Sektoriale është Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë të Kosovës, rezulton se këtu të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, duke u bazuar në faktin se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës së cekur, e paditura konsideron se nuk mund të obligohet për kompensimin e pagave jubilarë të paditësve është i paqëndrueshëm nga fakti se për punëdhënësin gjegjësisht për këtu të paditurën përfshihen të gjitha institucionet shëndetësore nga sektori publik në tri nivelet e organizimit të sistemit shëndetësor sipas Ligjit për shëndetësinë nënshkruese është Ministria Shëndetësisë ndërsa për punëmarrësit Federata e Sindikatave të Shëndetësisë të Kosovës, e që nga kjo rezulton se punëdhënësi i paditësve është e paditura, që është punëdhënësi i fundit dhe ka detyrime për kompensimin e pagave jubilarë dhe pagave të 13 (trembëdhjeta) siç është vendosur më lartë.

Punëdhënësi këtu e paditura në bazë të Kontratave të punës të nënshkruara me paditësit si të punësuar, neni 22 është përcaktuar se dispozitat e kontratës së punës nuk mund të jenë më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin, se dispozitat e Ligjit të punës ose të Kontratës Kolektive, për sa u përket të drejtave dhe kushteve nga marrëdhënie juridike e punës. Mbi këtë bazë pretendimet e palës së paditur ishin pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe TA ku paditësve ju ka njohur të drejtën e shpenzimeve procedurale për taksë gjyqësore shumën 60.00 €, për përpilim të padisë shumën 312.00€, përfaqësim në një seancë shuma 405.60€, gjithsejtë shumën 777.60€.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë, pasiqë, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j),

(k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, dhe se e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Përkitazi me kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e pagave të 13-ta për vitin 2018, 2019 dhe 2020, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase ashtu siç ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, me dispozitat e nenit 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me parag.3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tre (3) vjet”.*

Me dispozitën ligjore të nenit 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018 parashihet se *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*

Nga interpretimi i kësaj dispozitave ligjore, si dhe Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme me numër , 212/2023, i datës 09.10.2023, lidhur me plotësimin e kushteve ligjore për kompensimin e kushteve ligjore për shpërblimin e pagës së 13-të, Gjykata e Apelit, nuk e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale. Sipas Gjykatës së Apelit, çështja e kompensimit të pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizmin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Andaj, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit-pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë.

Në rastin konkret, e paditura nuk ka ofruar asnjë provë për ta mbështetur pretendimin e saj se nuk ka mjete buxhetore për t'ia kompensuar pagës së 13-të paditësit, në kuptimin e nenit 7 lidhur me nenin 319 të LPK-së dhe nenin 322 paragrafi 3 të LPK-së ku parashihet se *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar*

krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”, andaj, Gjykata e Apelit e aprovon ankesën a paditësit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të themeltë.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat neni e 449 dhr 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5309/21, datë 19.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka